Transferte e pakushtezuar e pa perdorur	76,348,194	Planifikimi, Menaxhimit dhe Administrimit	0 1110	23,544,671	3,043,356	799,500	3,599,875	15,181,940				920,000		
		Sherbimet Policore	0 3140	444,570	399,570	45,000								
		Strehimi	0 6190	-										
		Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	0 4240	940,353	671,042	66,000	203,311							
		Administrimi i Pyjeve dhe kullotave	0 4260	13,464,468	5,365,130		6,502,458	1,596,880						
		Rrjeti rrugor rural	0 4520	41,990,995			3,154,737	38,836,258						
Transferte e pakushtezuar sektoriale e pa perdorur	19,089,531	Kujdesi social per personat e semure dhe me aftësi të kufizuar (Qendra Ditore femijeve me AK)	0 10430	2,418,945	1,735,000	80,000	603,945							
		Shërbimet Publike	0 6260	4,212,026	1,798,000	260,000	1,654,026	500,000						
		Shërbimi pastrimit dhe transporti mbetjeje urbane	0 6260	2,192,067			2,192,067							
		Sport dhe argëtim	0 8130	-										
Te ardhura te celura te paperdorura	23,481,765	Trashëgimi kulturore, evente artistike dhe kulturore	0 8220	2,109,603	750,000	100,000	519,603	240,000	500,000					
		Arsimi baze dhe parashkollor	0 9120	25,089,399	9,593,106	3,364,799	8,334,737	2,506,757	1,290,000					
Te ardhura jashte limiti te paperdorura	419,672	Arsimi Mesem i pergjithshem	0 9230	2,113,987	2,000,000	113,987								
		Furnizimi me ujë	0 6370	-										
		Çerdhja e femijeve	0 10430	1,692,000	1,493,000	199,000								
		Menca Sociale	0 10430	419,672			419,672							
		Menaxhi i mbetjeje urbane	0 5100	732,120			732,120							
Te ardhura te paperdorura	8,183,210	Mbrojtja nga zjari dhe mbrojtja civile	0 3280	4,927,496			1,427,496		3,500,000					
		Fond Kontigjence	0 4980	-										
		Emergjencat Civile	0 3280	-										
		Mbeshtetje per te moshuarit	10430	1,230,000			1,230,000							
Shuma i	127,522,372			127,522,372	26,848,204	5,028,286	30,574,047	58,861,835	5,290,000	-	920,000	-		



**Transferta e pakushtëzuar,transferta e pakushtëzuar sektoriale dhe të ardhurat të cila trashëgohen për vitin 2024 në vlerën 127,522,372 lekë kryesisht janë si me poshte:**

- paga –sigurime shoqërore ne vleren 31,876,490 leke të cilat plotësojnë fondin e kërkuar për paga dhe sigurime shoqërore per vitin 2024 sipas strukturës së punonjësve të bashkisë miratuar me VKB nr 116,date 29.12.2023 dhe nivelit te kategortizimit te pagave miratuar me VKB nr.117,date29.12.2023.
- shpenzime operative ne vleren 30,574,047 leke qe vijne si rezultat i marrveshjeve kuader qe kane shtrirje pertej vitit 2023.
- Ndihme financiare per personat e diagnostikuar me semundje te pa sherueshme ne vleren 920,000 leke miratuar me VKB ne muajin dhjetor ne pritje te konfirmimit.
- Investime ne vleren 58,861,835leke të cilat jane ne proces marrje ne dorzim ose ne pritje te afateve.
- Investime te reja ne vleren 5,290,000 leke te cilat vijne nga kursimet e kontratave te ezauruara gjate vitit 2023.


### **Detyrime te prapambetura**

Nga akt-rakordimi me degën e Thesarit Librazhd detyrimet e prapambetura në fund te vitit 2023 janë:

<b>Nr.</b>	<b>Bashkia</b>	<b>Detyrimi i mbetur deri në Dhjetor 2023</b>
1	Mbikqyrje Ndertim i ujesjellesit te fshatit Polis Gostim,Nj.Adm.Polis, Bashkia Librazhd	698,449
2	Mbikqyrje Hidroizolimi I shkollave dhe institucioneve ne bashki	54,000
3	Blerje peme dekorative ,fare bari,lule dhe pesticide per dezinfektim,deratizim te institucioneve te bashkise dhe institucionet arsimore	283,300
4	Sistemim asfaltim I rruges se fshatit Cercan	1,000,000
		<b>2,035,749</b>


**P/Buxhetit**

**Emanuela Çekrezi**



**D/Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar**

**Afërdita Alla**





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA LIBRAZHD  
KRYETARI

P/ VENDIM

NR \_\_\_ DATE \_\_\_/01.2024

“PER NJE NDRYSHIM NE VKB NR. 119 ,DATE 29.12.2023 ”PER MIRATIMIN E  
BUXHETIT TE VITIT 2024 TE BASHKISE LIBRAZHD DHE PROGRAMIT  
PERFUNDIMTAR BUXHETOR AFATMESEM 2024-2026 ”

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 Date 17.12.2015 “Për Vetqeverisjen Vendore , te Ligjit Nr.9936 Date 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë “ , i ndryshuar në Ligjin Nr.68 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” si dhe në Udhezimin nr. 23 ,datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore” , Këshilli i Bashkisë i mbledhur sot më datë \_\_\_/01/2024 me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.

VENDOSI :

1. Të miratojë sistemim veprimi ne V.K.Bnr.119 date 29.12.2023 tabela  $\frac{3}{4}$  per projektin “Mbeshtetje per te moshuarit” si me poshte:

Pakesim fondi :

Grupi	Tit.	Kap.	Art .	Vlera ne leke
00	10430	0 6	600	469,000 lekë shpenzime per paga

Shtese fondi:

Grupi	Tit.	Kap.	Art .	Vlera ne leke
00	10430	0 6	231	140,000 lekë Mobilim I qendres se sherbimeve komunitare
00	10430	0 6	602	329,000 lekë Shpenzime operative

2. Ndjek zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar .
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes.

**KRYETARI I BASHKISE**

~~Mariglen Disha~~


## Relacion

### Mbi sistemimin e veprimit per projektin “Mbeshtetje per te moshuarit”

Te nderuar keshilltare ,

Gjate hartimit te buxhetit te vitit 2024 jane trasheguar fondet e disponueshme per projektin “Mbeshtetje per te moshuarit”. Sipas marrveshjes te miratuar me vkb nr.99 date 31.10.2023 vlera totale e ketij projekti eshte 4,467,828 leke dhe financimi nga UNDP eshte 2,997,828 leke nga te cilat kesti i pare eshte derdhur menjehere pas nenshkrimit te marrveshjes ne vleren 2,262,414 leke. Kesti i radhes do te derdhet pas realizimit 80% te kestit te pare. Nga sektori juridik jane bere procedurat e prokurimit duke u bazuar ne vkb nr 99 date 31.10.2023. Eshte lidhur kontrata “Mobilim i qendres se sherbimeve komunitare” si dhe eshte ngritur urdhri i prokurimit per blerje automjet per ofrimin e sherbimeve. Per t’iu permbajtur ligjit te menaxhimit financiar per likujdim te faturave brenda afatit 30 ditor kerkojme sistemim te zerit shpenzime per paga (pa ndikuar ne likujdim te pagave te personelit) ne vleren 469,000 leke qe te kemi mundesi likujdimin e faturave dhe per t’iu permbajtur marreveshjes mbi realizimin 80% te kestit te pare .

P/Buxhetit  
Emanuela Çekrezi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LIBRAZHD  
SEKTORI I MBROJTJES CIVILE

PROJEKT - VENDIM

Nr. 64 datë 17/07/2024

**PËR MIRATIMIN E DOKUMENTACIONIT TEKNIKO – LIGJOR PËR  
AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJET QË KANË PËSUAR  
DËME (DEMTIM TE GJESE SE GJALLE) NGA FATKEQËSI NATYRORE.**

Në mbështetje të ligjit Nr. 139/2015 dt.17.12.2015 “ *Për vetëqeverisjen vendore.*”;ligjit Nr. 45/2019 datë 18.07.2019 “*Për Mbrojtjen Civile,*” VKM –së Nr. 329 datë 16/05/2012 “*Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare , për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore*”, Kreu III/3/e ,Vendimin e Keshillit Bashkiak Nr 119 dt 29.12.2023 Pasi shqyrtoi relacioni e paraqitur nga Sektori i Mbrojtjes Civile dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar. “Për dhënien e ndihmës financiare, për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësi natyrore (ronie zjarri,djegje bagetish ) në pronesi të **Z BAJRAM MURRASHI** banore i fshatit Arrez , NJ. A.Qender, Bashkia Librazhd.

Këshilli Bashkiak me propozim të Kryetarit të Bashkisë në mbledhjen e datës. \_\_\_/\_\_\_/ 2024.

**VENDOSI :**

- 1- Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të përgatitur nga specialistët e Bashkisë Librazhd dhe vlerën financiare të dëmit në shumën **207500** lekë, për demin e shkaktuar nga fatkeqësia natyrore (*dëmtim te gjese se gjalle.*) të shtetasit Bajram MURRASHI

2- Ti jape familjes së shtetasit Bajram MURRASHI ndihmën emergjente në vlerën financiare prej : **207.500** lekë nga **buxheti i Bashkisë Librazhd , fondi i emergjencave civile i destinuar dhe i miratuar ne Këshillin e Bashkisë . ,**

3- Ndjek zbatimin e ketij vendimi Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Sektori i Mbrojtjes Civile.

4- Ky vendim hyn ne fuqi 10 dit pas shpalljes nga Prefekti i Qarkut Elbasan

KRYETARI I BASHKISË

~~Mariglen DISHA~~





REPUBLIKA E SHQIPERISË  
KËSHILLI I BASHKISË  
LIBRAZHD

P/VENDIM

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_/\_\_\_\_\_/2024

**“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË NGASTRAVE KU DO TË LEJOHET KULLOTJA  
DHE KOSITJA E BARIT PËR VITIN 2024”**

Mbështetur në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”,neni 54 pika f, ligjin nr.9693,datë 19.03.2007 “Për Fondin Kulllosor” i ndryshua me Ligjin 9996 datë 22.09.2008 “Për disa ndryshime në ligjin Nr.9693 datë 19.03.2007 “Për fondin kulllosor”,VKM nr.433 datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike,sipas listës së inventarit,dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive i ndryshuar”.

VKM nr.632,datë 11.07.2009 “Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje”,Udhëzimit nr.2 datë 20.07.2016, “ Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave dhe livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari”,kreu II pika 2 ,Këshilli i Bashkisë Librazhd i mbledhur sot më datë \_\_\_\_\_/\_\_\_\_\_/2024, pasi dëgjoi relacionin e Drejtorisë Menaxhimit dhe Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave.

**VENDOSI :**

1.Të miratojë listën e ngastrave ku do të lejohet kullotja e kositja e barit për vitin 2024 si më poshtë :

Nr.	Qarku	Bashkia	Kodi kadastral	Ekonomia Pyjore/Kulllosore	Ng./nëng.	Sip. ha	Kategoria përdorimit të territorit	Të imta dhen/dhi	Të tras ha	Koeficenti
1	Elbasan	Librazhd	EL02 00 001	EK,Dardhë-Polis	1	46.45	Kullotë	167	0	3.6
2	Elbasan	Librazhd	EL06 00 008	EK Mali Plak	8	206.4	Kullotë	968	0	4.7
3	Elbasan	Librazhd	EL06 00 012	EK Mali Plak	12	45.8	Kullotë	128	0	2.8
4	Elbasan	Librazhd	EL06 00 014	EK Mali Plak	14	78.85	Kullotë	661	9	9.3
5	Elbasan	Librazhd	EL06 00 015	EK Mali Plak	15	63.6	Kullotë	357	3	6
6	Elbasan	Librazhd	EL06 00 016	EK Mali Plak	16	104.36	Kullotë	631	15	7.2
7	Elbasan	Librazhd	EL06 00 017	EK Mali Plak	17	69.85	Kullotë	384	0	5.5
8	Elbasan	Librazhd	EL06 00 018	EK Mali Plak	18	146.59	Kullotë	956	5	6.8
9	Elbasan	Librazhd	EL06 00 019	EK Mali Plak	19	99.31	Kullotë	670	28	9
10	Elbasan	Librazhd	EL06 00 020	EK Mali Plak	20	94.09	Kullotë	751	6	8.5
11	Elbasan	Librazhd	EL06 00 021	EK Mali Plak	21	78.82	Kullotë	456	8	6.6
12	Elbasan	Librazhd	EL06 00 022	EK Mali Plak	22	191.62	Kullotë	1375	15	7.8

13	Elbasan	Librazhd	EL06 00 023	EK Mali Plak	23	54.53	Kullotë	787	10	15.9
14	Elbasan	Librazhd	EL06 00 027	EK Mali Plak	27	242.46	Kullotë	2339	38	10.9
15	Elbasan	Librazhd	EL20 00 003b	EP Çermenikë	3b	245	Kullotë	490	0	2
16	Elbasan	Librazhd	EL20 00 007b	EP Çermenikë	7b	49.5	Kullotë	64	0	1.3
17	Elbasan	Librazhd	EL20 00 009b	EP Çermenikë	9b	66.5	Kullotë	80	0	1.2
18	Elbasan	Librazhd	EL20 00 010a	EP Çermenikë	10a	25.54	Kullotë	31	0	1.2
19	Elbasan	Librazhd	EL20 00 011a	EP Çermenikë	11a	20.87	Kullotë	25	0	1.2
20	Elbasan	Librazhd	EL20 00 012b	EP Çermenikë	12b	26.13	Kullotë	37	0	1.4
21	Elbasan	Librazhd	EL20 00 014b	EP Çermenikë	14b	69.5	Kullotë	118	0	1.7
22	Elbasan	Librazhd	EL20 00 015b	EP Çermenikë	15b	80	Kullotë	160	0	2
23	Elbasan	Librazhd	EL20 00 027b	EP Çermenikë	27b	46.63	Kullotë	61	0	1.3
24	Elbasan	Librazhd	EL20 00 031b	EP Çermenikë	31b	25.16	Kullotë	53	0	2.1
25	Elbasan	Librazhd	EL20 00 032d	EP Çermenikë	32d	27	Kullotë	62	0	2.3
26	Elbasan	Librazhd	EL20 00 033d	EP Çermenikë	33d	21	Kullotë	40	0	1.9
27	Elbasan	Librazhd	EL20 00 039b	EP Çermenikë	39b	37.5	Kullotë	98	0	2.6
28	Elbasan	Librazhd	EL20 00 040b	EP Çermenikë	40b	39	Kullotë	101	0	2.6
29	Elbasan	Librazhd	EL21 00 001b	EP,Dardhë-Xhyrë	1b	16.27	Kullotë	154	0	9.5
30	Elbasan	Librazhd	EL21 00 056d	EP Dardhë-Xhyrë	56d	9.23	Kullotë	73	0	4.5
31	Elbasan	Librazhd	EL21 00 058c	EP Dardhë-Xhyrë	58c	10.95	Kullotë	44	0	4
32	Elbasan	Librazhd	EL21 00 097	EP Dardhë-Xhyrë	97	243.98	Kullotë	1829	0	7.5
33	Elbasan	Librazhd	EL21 00 113a	EP Dardhë-Xhyrë	113a	9.02	Pyje,që kulloten	27	0	3
34	Elbasan	Librazhd	EL21 00 113b	EP Dardhë-Xhyrë	113b	11.63	Pyje,që kulloten	35	0	3
35	Elbasan	Librazhd	EL21 00 113c	EP Dardhë-Xhyrë	113c	7.95	Pyje,që kulloten	24	0	3
36	Elbasan	Librazhd	EL21 00 114a	EP Dardhë-Xhyrë	114a	11.85	Pyje,që kulloten	36	0	3
37	Elbasan	Librazhd	EL21 00 115a	EP Dardhë-Xhyrë	115a	10.96	Pyje,që kulloten	33	0	3
38	Elbasan	Librazhd	EL21 00 130b	EP Dardhë-Xhyrë	130b	7.04	Kullotë	35	0	5
39	Elbasan	Librazhd	EL21 00 156b	EP Dardhë-Xhyrë	156b	12.28	Kullotë	37	0	3
40	Elbasan	Librazhd	EL21 00 164b	EP Dardhë-Xhyrë	164b	18.36	Kullotë	51	0	2.8
41	Elbasan	Librazhd	EL21 00 165c	EP Dardhë-Xhyrë	165c	19.34	Kullotë	54	0	2.8
42	Elbasan	Librazhd	TR22 00 019b	EP Fushë Gurrë	19b	6	Kullotë	18	0	3
43	Elbasan	Librazhd	TR22 00 020b	EP Fushë Gurrë	20b	8	Kullotë	24	0	3
44	Elbasan	Librazhd	TR23 00 006b	EP Kostenjë	6b	14.7	Kullotë	44	0	3
45	Elbasan	Librazhd	TR23 00 008b	EP Kostenjë	8b	10.9	Kullotë	33	0	3
46	Elbasan	Librazhd	TR23 00 010a	EP Kostenjë	10a	7.9	Kullotë	24	0	3
47	Elbasan	Librazhd	TR23 00 074b	EP Kostenjë	74b	23.31	Kullotë	70	0	3
48	Elbasan	Librazhd	EL33 00 019	EP Klenjë	19	180.65	Kullotë	542	0	3
49	Elbasan	Librazhd	EL33 00 020a	EP Klenjë	20a	282.64	Kullotë	848	0	3
50	Elbasan	Librazhd	EL33 00 022b	EP Klenjë	22b	133.26	Kullotë	400	0	3
51	Elbasan	Librazhd	EL33 00 023b	EP Klenjë	23b	207.92	Kullotë	935	0	4.5
52	Elbasan	Librazhd	EL33 00 086a	EP Klenjë	86a	53.61	Kullotë	429	0	8
53	Elbasan	Librazhd	EL33 00 090b	EP Klenjë	90b	174.72	Kullotë	1222	0	7
54	Elbasan	Librazhd	EL33 00 095c	EP Klenjë	95c	92.79	Kullotë	741	0	8
55	Elbasan	Librazhd	EL33 00 100	EP Klenjë	100	213.39	Kullotë	1279	0	6
56	Elbasan	Librazhd	EL33 00 101	EP Klenjë	101	270.62	Kullotë	1623	0	6
57	Elbasan	Librazhd	EL45 00 008c	EPNeshtë-Prevall	8c	14.75	Kullotë	29	0	2

58	Elbasan	Librazhd	EL45 00 009c	EPNeshtë-Prevall	9c	109	Kullotë	196	0	1.8
59	Elbasan	Librazhd	EL45 00 012b	EPNeshtë-Prevall	12b	26.71	Kullotë	45	0	1.7
60	Elbasan	Librazhd	EL45 00 039b	EPNeshtë-Prevall	39b	175.92	Kullotë	352	0	2
61	Elbasan	Librazhd	EL45 00 088b	EPNeshtë-Prevall	88b	67.71	Kullotë	135	0	2
62	Elbasan	Librazhd	EL45 00 089b	EPNeshtë-Prevall	89b	64.57	Kullotë	135	0	2.1
63	Elbasan	Librazhd	EL21 00 015a	EP,Dardhë-Xhyrë	24ab (15a)	28.42	Pyje,që kulloten	71	0	2.5
64	Elbasan	Librazhd	EL21 00 01b	EP,Dardhë-Xhyrë	25b (16b)	15.09	Livadh,djerr	45	0	3
65	Elbasan	Librazhd	EL47 00 004a	EP Polis	4a	54.76	Pyje,që kulloten	219	0	4
66	Elbasan	Librazhd	EL47 00 005a	EP Polis	5a	24.83	Pyje,që kulloten	99	0	4
67	Elbasan	Librazhd	EL47 00 081b	EP Polis	81b	33.32	Kullotë	393	0	11.8
68	Elbasan	Librazhd	EL47 00 083b	EP Polis	83b	38.43	Kullotë	457	0	11.9
69	Elbasan	Librazhd	EL47 00 096b	EP Polis	96b	111.71	Kullotë	558	0	5
70	Elbasan	Librazhd	EL4700 102/1	EP Polis	102/1	127.81 9	Kullotë	511	0	4
71	Elbasan	Librazhd	EL47 00 106	EP Polis	106	462.4	Kullotë	1247	0	2.7
72	Elbasan	Librazhd	EL47 00 142b	EP Polis	142b	15.39	Kullotë	166	0	10.8
73	Elbasan	Librazhd	EL47 00 146b	EP Polis	146b	26.98	Kullotë	323	0	12
74	Elbasan	Librazhd	EL47 00 153b	EP Polis	153b	55.1	Kullotë	165	0	3
75	Elbasan	Librazhd	EL47 00 154b	EP Polis	154b	26.42	Kullotë	79	0	3
76	Elbasan	Librazhd	EL50 00 121a	EP Prodan	121a	40.77	Kullotë	81	0	2
77	Elbasan	Librazhd	EL50 00 126a	EP Prodan	126a	65.48	Kullotë	98	0	1.5
78	Elbasan	Librazhd	EL50 00 139b	EP Prodan	139b	9.62	Kullotë	19	0	2
<b>TOTALI</b>						<b>5967</b>		<b>28137</b>	<b>137</b>	

2. Proçedurat e mëtejshme ligjore do të ndiqen nga Drejtoria Menaxhimit dhe Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave të Bashkisë Librazhd.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas miratimit.

**KONCEPTOI:**

Drejtoria Menaxhimit dhe Administrimit Pyjeve dhe Kullotave  
Përgjegjësi Menaxhimit  
Ing. Bledar COTA

**DREJTORI**  
Aleksandër BRAZHDA

**KRYETARI I BASHKISË**  
Mariglen DISHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LIBRAZHD  
DREJTORIA MENAXHIMIT DHE ADMINISTRIMIT TE PYJEVE DHE KULLOTAVE

RELACION MBI PROJEKT-VENDIMIN

**“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË NGASTRAVE KU DO TË LEJOHET KULLOTJA DHE KOSITJA E BARIT PËR VITIN 2024**

Në mbështetje të ligjit nr.9693,datë 19.03.2007 “Për Fondin Kullor” i ndryshuar,nenit 15 (përdorimi për kullotje),pikat 1,2,3,4,5 dhe 6,nenit 17 (përdorimi i sipërfaqes dhe tokës) , ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet” date: 30.04.2020, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.632,datë 11.06.2009 “Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje”, si dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr.2,datë 20.07.2016 “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari”,kreu i II-të ,pika 1,2 Drejtoria Menaxhimit Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave sqaron si më poshtë :

Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.433,datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike,sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive”, i ndryshuar”, dhe kanë kaluar në përdorim një sipërfaqe prej **9433.7 ha** kullotë.

Nisur nga përvoja e viteve të mëparshme janë përfshirë disa ngastra të ekonomive pyjore me formë përdorimi pyll, “pyje që kulloten, djerr” me sipërfaqe prej **174 ha** të cilat janë në afërsi të fshatrave ku mund të jepen me qira.

Drejtorja Menaxhimit Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave pasi kreu studimin e të gjitha ngastrave të fondit kullor që ka në përdorim,në zbatim të Udhëzimit nr.2 datë 20.07.2016 “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari” kreu i II-të ,pika 1,2 paraqet listën e ngastrave që janë të gatëshme për kullotje e kositje bari për vitin 2024.

Nga **9433.7 ha** sipërfaqe kullorë që ka gjithësej në përdorim bashkia Librazhd,sipas studimit të kryer janë të gatshme për kullotje e kositje bari ngastrat për një sipërfaqe prej **5967 ha**,nga të cilat **174 ha** janë pyje që kulloten, djerr me nje kapacitet prej **28137** krerë të imta dhe të trasha **137** krerë.

Ndërsa sipërfaqja prej **3642 ha** për vitin 2024 sipas studimit të kryer duhet të mos kullotet për të përmirësuar gjëndjen e kullotjes.

**Për sa më sipër i kërkojmë Këshillit Bashkiak të miratojë “Listën e ngastrave të kullotave e livadheve të gatëshme për kullotje e kositje bari për vitin 2024” në mënyrë që Drejtoria Menaxhimit Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave të vazhdojë procedurat e mëtejshme për dhënie me qera të kullotave e livadheve.**

Jemi në pritje të miratimit nga ana J’uaj.

Përgjegjësi i Menaxhimit

Ing.Bledar COTA

DREJTORI

Aleksandër BRAZHDA



**REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA LIBRAZHD**

Nr. \_\_\_\_ prot.

Date \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROJEKT/VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_ dt. \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PRONONCIM PER PERFSHIRJE NE PROCEDURE PRIVATIZIMI**

Ne zbatim te ligjit nr 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore" te ndryshuar, VKM nr. 926, date 29.12.2014 "Per kriteret e vleresimit te prones shtetore qe privatizohet apo transformohet dhe proceduren e shitjes" te ndryshuar dhe udhezimit ne zbatim te tij, shkreses nr. 1279/1, date 09.06.2023 nga Ministria e Financave dhe Ekonomise, Drejtoria e Pergjithshme e Prones Publike, Drejtoria e Privatizimit dhe Shitjes, ku kerkojne prononcim per perfshirje ne procedure privatizimi te prones brenda pasurise nr. 7/8 N-5 lloji ndertese, e cila figuron e rregjistruar ne pronesi te Bashkise Librazhd ne zbatim te VKM nr 1086 date 28.10.2009, dhe ne zbatim te VKM nr 819 date 29.11.2007 "Per privatizimin e pasurive te ndermarrjeve apo te institucioneve shtetore" pika 2, ne baze te funksioneve ne mbledhjen e dates \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024 te :

**VENDOSI:**

- 1.Prononcim pozitiv ose negativ per perfshirje ne procedure privatizimi te ambientit (dhome) e llojit ndertese te paprivatizuar ne 'Ish Klinikene dentare" te Qendres Stomatologjike Shtetore Librazhd e cila ndodhet brenda pasurie me nr. 7/8-N5.
- 2.Ndjek zbatimin e ketij vendimi Kryetari i Bashkise, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit, Sektori Juridik dhe Sektori i Menaxhimit te Aseteve.
- 3.Ky vendim hyn ne fuqi 10(dhjete) dite pas shpalljes.

**KRYETARI I BASHKISE  
MARIGLEN DISHA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LIBRAZHD  
KRYETARI

**P/V E N D I M**

Nr. \_\_\_\_, datë \_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PËR MIRATIMIN E FILLIMIT TË PROCEDURËS PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TE TË TRETËT TË PIKËS SË GRUMBULLIMIT TË PRODUKTEVE BUJQËSORE BLEGTORALE “FOOD HUB”**

Mbështetur në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015“Per veteqeverisjen Vendore” të ndryshuar, Neni 54, bazuar në kompetencat ligjore dhe funksionet dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e dates \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024 të :

**VENDOSI:**

1. Miratimin e fillimit të procedurës për dhënie në përdorim te të tretët të pikës së grumbullimit të produkteve bujqësore blegtorale “FOOD HUB”;
2. Ndjek zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkisë, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Bujqësisë, Administrimit të Ujitjes dhe Kullimit;
3. Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjete) dite pas shpalljes.

**KRYETAR I BASHKISË  
MARIGLEN DISHA**

P



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBRAZHË

KRYETARI

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Librazhd. \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROJEKT/VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_ Date \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROPOZIM PER DHENIEN NE PERDORIM TE PASURISE SHTETERORE**

Mbeshtetur ne Ligjin nr.139/2015 “Per veteqeverisjen vendore” te ndryshuar, bazuar ne kompetencat qe na jep ligji, me propozim te kryetarit te bashkise ne mbledhjen e dates \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024 te :

**VENDOSI :**

1. Miratimin e dhenies me qira te pasurise shteterore truall te identifikuar me nr.A, e cila ndodhet brenda pasurise nr.3/20 ZK 2446, me siperfaqe 52.5 m2, me afat 1 vjecar me veprimtari aktivitet tregtar sipas genplanit bashkengjitur.
2. Tarifa dysheme i detyrimit mujor per truallin e lire te jete 100 leke/m2.
3. Autorizimin e kryetarit te bashkise per te kryer procedurat perkatese te parashikuara ne ligj per neshkrimin e kontrates se qirase.
4. Ndjek zbatimin e ketij vendimi administrata e Bashkise Librazhd.
5. Ky vendim hyn ne fuqi 10(dhjete) dite pas shpalljes.

**KRYETARI I BASHKISE**

**MARIGLEN DISHA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LIBRAZHD  
KRYETARI

**P/V E N D I M**

Nr. \_\_\_\_, datë \_\_\_\_. \_\_\_\_. 2024

**PËR VLERSIMIN ME TITULLIN “  
QYTETAR NDERI” Z.ALI KOPAÇI**

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 54, germa m, Këshilli Bashkiak i mbledhur sot më datë \_\_\_\_/01/2024 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd:

**VENDOSI:**

- 1.Z.Ali Rustem Kopaçi të vlersohet me titullin “Qytetar Nderi” me motivacion:  
“ Për merita në drejtimin dhe zhvillimin ekonomik, industrial të Librazhdit”
- 2.Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkisë, Drejtorja e Arsimit dhe Kulturës .
- 3.Ky vendim hyn ne fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

**KRYETAR I BASHKISË  
MARIGLEN DISHA**

Librazhd, më 15.11.2023

**KËSHILLIT BASHKIAK TË BASHKISË**  
**LIBRAZHD.**

Lënda: Propozim për shpalljen “Qytetar Nderi” (Pas vdekjes), të Z. ALI RUSTEM KOPAÇI.

Z. Mitat Biçaku, Kryetar i Këshillit Bashkiak,  
Këshilltare e Këshilltarë të këtij Këshilli,

Ju urojmë suksese në punën Tuaj!

Një grup veteranësh, bashkëkohës të z. Ali Kopaçi, intelektualë dhe qytetarë të Bashkisë Librazhd, propozojmë që Z. ALI RUSTEM KOPAÇI. për kontributin e shquar që ka dhënë në shërbim të Atdheut dhe të rrethit tonë, të shpallet “Qytetar Nderi” i kësaj bashkie (pas vdekjes). Më 19 janar 2024 Ai mbush 29 vjet që është ndarë nga kjo jetë. Më poshtë po ju njohim me jetëshkrimin e shkurtër të Tij:

Aliu lindi në një familje atdhetare në fshatin Qukës-Skënderbe. Ditëlindja e Tij zyrtare është më 10 qershor 1927, por ditëlindja e vërtetë është një vit më vonë; 10 qershor 1928. U detyrua të rriste një vit moshën, pasi vullnetarisht ishte regjistruar në Çetën e Bërzeshtës dhe ata nuk e regjistronin, pa mbushur 15 vjeç. Ka ndërruar jetë në moshën 67-vjeçare, më 19 janar 1995. Që në moshë të vogël, e deri në fund, tërë fuqitë e Tij intelektuale e fizike, i vuri në shërbim të Atdheut, në zhvillimin e sektorëve shtetërorë të ekonomisë së rrethit, si në ato të ekonomisë, industrisë, bujqësisë, kulturës edukimit etj.

Më 14 maj 1944 e regjistrojnë në formacionin partizan të Çetës së Bërzeshtës, por ai kishte kohë që kishte ardhur vullnetarisht në këtë çetë, më pas në batalionin me të njëjtin emër, në fund në Brigadën XVII Sulmuese, deri në çlirimin e vendit. Megjithëse i ri, mori pjesë në të gjitha luftimet e kësaj brigade, duke treguar guxim e trimëri.

Pas Çlirimit, mbaron fillimisht Shkollën e mesme Ekonomike në Elbasan.

Në vitet 1949-1950 mbaron Kursin për oficer në Shkollën e Bashkuar, emërohet në punë si oficer në Burrel, Vlorë, Tiranë, Kavajë e Elbasan. Për një kohë të shkurtër, për punë të shkëlqyer, arrin të gradohet “major.”

Në vitin 1950 martohet me Sofie Blloshmin, vajza e Qazim Blloshmit, familje e nderuar nga fshati Fanjë, lindi 3 djem e një vajzë, ndër ta Yllin, i cili, në zgjedhjet e 14 Majit të këtij viti, i propozuar nga Organizata e Dëshmorëve, është në listën e këshillit bashkiak.

Në vitin 1956 sëmuret rëndë nga të ftohtit dhe lirohet nga ushtria. Tashmë kuadrot e kohës kishin evidentuar te Aliu cilësitë të larta morale, organizative, përkushtimin ndaj punës dhe te ta ishte krijuar ideja se sektorët më të vështirë, mund t'i drejtojë dhe t'i nxjerrë nga prapambetja vetëm Aliu dhe Ai, duke fituar edhe betejën me sëmundjen e të ftohtit, kështu bëri.

-Më 1 prill 1957 caktohet përgjegjës për ngritjen e Stabilimentit, Sharra Stravaj.

-Më 15 nëntor 1959 emërohet drejtor i Shtëpisë së Kulturës Librazhd.

-Më 1 mars 1960 kyetar i Kooperativës Qukës-Skënderbe.

-Në vitin 1964 rikthehet pët të ringritur Stabimentin, Sharra Stravaj.

-16 janar 1966, drejtor i Ndërmarrjes Bujqësore të sapongritur.

-16 mars 1966, kryetar Lokaliteti Qukës.

2.

- 2 shtator 1968, emërohet sekretar i Komitetit Ekzekutiv, njëkohësisht i caktohet detyra e Kryetarit të Elektrifikimit të rrethit, një nga detyrat më të vështira; një rreth me sipërfaqe të madhe dhe terren shumë të vështirë malor, detyrë të cilën e kreu me shumë sukses.

Për më shumë se 15 vjet rrjesht, prej tetorit 1970, deri më 31.12.1985, kur del në pension, punon si drejtor i Ndërmarrjes së Pëpunim Drurit, në atë kohë një ndër ndërmarrjet më të mëdha pararojë e model në shkallë vendi.

Edhe pas daljes në pension, Aliu zgjidhet kryetar i Organizatës së Veteranëve të rrethit.

Krahasur me shumë kuadro të tjerë të kohës, Aliun e karakterizonin cilësi të rralla si; karakteri burrëror, dhemshuria dhe ndjeshmëria për të varfërit, të persektuarit e sistemit, të pastrehët, duke i ndihmuar, duke i futur në punë, cilësi këto që shpesh i shkaktuan telashe, kritika të forta në mbledhjet e organeve drejtuese të rrethit, por ishin zotësia e Tij në të argumentuar, burrëria, qëndrueshmëria e rezultatet në punën drejtuese që bënin që gjithmonë të dilte fitimtar.

Drejtuesit kryesorë të rrethit e shihnin me mosbesim Aliun edhe për një arsye tjetër. Një motër e Tij në vitin 1937 ishte martuar te një familje e pasur te Ballajt në Babje. Pas Çlirimit sistemi i konfiskoi kësaj familjeje të gjithë pasurinë dhe e shpalli "kulak". Por këta drejtues tregoheshin të kujdesshëm me Aliun se e dinin se me kë kishin të bënin.

Vlerat Aliut ja kanë ngritur edhe bashkëshortja, një grua e nderuar, vëllezërit e Tij, fëmijët me sjelljen dhe punën e tyre.

Për punën e bërë dhe qëndimin e Tij, Aliu është dekoruar mbi 10 herë, me dekorata të tilla si; "Medalja e Çlirimit", ajo e "10-Vjetorit të Ushtrisë", "Urdhëri i Punës të Klasit të Parë", "Ylli i Kuq" të Klasit I", Urdhëri "Për shërbime të shquara shtetërore dhe shoqërore" etj.

Puna e palodhur, vështirësitë, përplasjet e herëpashërëshme me kuadro të sistemit dhe më në fund sëmundja e pashërueshme e stomakut, bënë që zemra e Tij të pushojë para kohe, në moshën 67-vjeçare, duke lënë pas modelin e një intelektualit, kuadri, njeriu të dhembshur, qytetari e familjari shembullor, njeriu fisnik që shkëlqeu në të gjitha punët dhe mbi të gjitha ruajti si rrallëkush të paprekur personalitetin e Tij burrëror.

Duke e shpallur "Qytetar Nderi", mendojmë se kryejmë një detyrë atdhetare ndaj punës dhe veprës së Tij, njëkohësisht edhe të punës, sjelljes e përkushtimit të bashkëshorte Sofies, e cila jeton, vëllezërve, fëmijëve e të afërmeve.

Kemi besim të plotë se kërkesa jonë do merret parasyshtë.  
Edhe njëherë ju urojmë suksese!

NJË GRUP VETERANËSH, BASHKËKOHËS TË Z. ALI KOPAÇI, INTELEKTUALË DHE  
QYTETARË TË BASHKISË LIBRAZHD,

Bashkëngjitur është edhe lista em firmat përkatëse.

1. Fiqiri Bicahe ~~Amir~~
2. Redhep ~~Amir~~
3. Romazan Terzi ~~Amir~~
4. Emin Prohadi ~~Amir~~
5. Agim Zhami ~~Amir~~
6. Shalim Balloli ~~Amir~~
7. ENVER H. KOCI ~~Amir~~
8. Abedin Koci ~~Amir~~
9. Rustem Muxati ~~Amir~~
10. ~~Amir~~
11. ~~Amir~~
12. Hajredin Balla ~~Amir~~
13. Emin Spaholli ~~Amir~~
14. Ajif Mijedta ~~Amir~~
15. Lorenc Kume ~~Amir~~
16. Hjeladin Muxati ~~Amir~~
17. ~~Amir~~
18. SABRI MYRZI ~~Amir~~
19. AFADHE MYRZI ~~Amir~~
20. XHESILA MYRZI ~~Amir~~
21. AHEVAT MYRZI ~~Amir~~
22. Hazis Lusli ~~Amir~~
23. NDRICMY XHIMI ~~Amir~~
24. Shaban Balla ~~Amir~~
25. Besim Dobra ~~Amir~~
26. Skender ~~Amir~~
27. Anesti Poci ~~Amir~~
28. Haxhi Allaga ~~Amir~~
29. Vekri Bicahe ~~Amir~~
30. Jounz Goci ~~Amir~~





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LIBRAZHD  
KRYETARI

**P/V E N D I M**

Nr. \_\_\_\_, datë \_\_\_\_. \_\_\_\_.2024

**PËR VLERSIMIN ME TITULLIN “  
QYTETAR NDERI” Z.HAXHI DEDE BABA EDMOND BRAHIMAJ**

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”,Neni 54,germa m,Këshilli Bashkiak i mbledhur sot më datë \_\_\_\_/01/2024 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd:

**VENDOSI:**

1.Z.Haxhi Dede Baba Edmond Brahimaj vlersohet me titullin “Qytetar Nderi” me motivacion:

“ Për merita në kultivimin e vlerave të besimit fetar dhe lirisë tek besimtarët bektashianë e më gjerë,në Bashkinë Librazhd”

2.Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës .

3.Ky vendim hyn ne fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

**KRYETAR I BASHKISË  
MARIGLEN DËSHA**

# **JETËSHKRIMI I KRYEGJYSHIT BOTËROR BEKTASHIAN SHENJTËRIA E TIJ, HAXHI DEDE BABA, EDMOND BRAHIMAJ**

Dede Edmond Brahimaj, ka lindur në Tiranë, më 19 maj 1959, prej prindërisht besimtarë të devotshëm të bektashizmit, me origjinë nga fshati Brataj i Vlorës. Pas mbarimit të shkollës 8 vjeçare, vazhdon studimet në shkollën e mesme ushtarake “Skënderbej” dhe, duke arritur rezultate të larta, i jepet e drejta të ndjekë studimet e larta ushtarake, në Akademinë e Forcave Tokësore, sot “Akademia Skënderbej”. Nga viti 1982, deri më vitin 1990 ka shërbyer në funksione të ndryshme ushtarake, në Burrel dhe Peshkopi. Me ringjalljen e besimit bektashian në fund të viteve 90-të, së bashku me klerikë dhe besimtarë të tjerë, merr pjesë në Këshillin Organizativ të Selisë së Shenjtë të Kryegjyshit Botëror Bektashian. Për rihapjen e saj.

Në fillim të vitit 1991, me kërkesën e tij lirohet nga funksioni ushtarak duke marrë përsipër barrën për organizimin e Komunitetit Bektashian. Vlen të theksojmë se edhe në kushtet më të vështira, atëherë kur ushtrimi i besimit fetarë në Shqipëri u ndalua, me nen të veçantë të Kushtetutës, shtëpia e prindërve të tij në Tiranë ka shërbyer për mbajtjen gjallë të bektashizmit duke u rrezikuar shumë prej regjimit që nuk falte.

Më dy janar të vitit 1992 merr dorë tek udhëheqësi i tij shpirtëror, Haxhi Dede Reshat Bardhi dhe Baba Barjam Mahmutaj, duke u inkuadruar kështu përfundimisht në rrugën e Pirit të ndritur Haxhi Bektash Veliut. Këtu zë fill karriera e tij fetare. Më 16 maj 1996 konsakrohet me urdhrin “Dervish”, menjëherë ngarkohet me detyrë në Gjyshitën Bektashiane Korçë, në teqenë e Turanit.

Puna e palodhur e tij për kontinuitetin dhe ringritjen e besimit bektashian në Librazhd, Pogradec, Mokër, Korçë, Devoll dhe Kavajë, bëri që më 13 prill të vitit 1997, dekretohet me titullin “Baba” dhe pas kalimit nga kjo jetë e baba Bajram Mahmutaj caktohet si zëvendës i parë i Kryegjyshit Botëror Bektashian Haxhi Dede Reshat Bardhi. Në këtë funksion të lartë kontributi i tij ka qenë i çmuar sidomos në ideimin, përgatitjen dhe realizimin e tri kongreseve të radhës, të bektashizmit. Madje, në dy kongreset e fundit (Tiranë 2000 dhe 2005), ka raportuar në cilësinë e përgjegjës të Këshillit të Lartë Gjyshëror.

Në marsin e vitit 2006, me kalimin nga jeta të Baba Tahir Emin, gjithashtu emërohet në funksionin e gjyshit të gjyshitës bektashiane në Maqedoni. Kontributi i tij në këtë gjyshitë ka qenë sa në rrafsh të organizimit të komuniteteve të besimtarëve atje, edhe në aspektin e njohjes prej ndërkombëtarëve. Si në Korçë edhe në Tetovë, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, ka manifestuar cilësitë e spikatura të klerikut bektashian në aspektin doktrinor, moral dhe qytetar duke u shndërruar në faktorin të tolerancës fetare midis besimeve të tjera. Në vitin 2004, për kontributin e çmuar të tij, Këshilli Bashkiak i Qarkut të Korçës, e ka nderuar me titullin më të lartë, “Nderi i Qarkut të Korçës”.

Ai ka marrë shumë falënderime dhe konsiderata të larta prej qeverive, të Shqipërisë dhe Maqedonisë Veriut, shoqatave civile. Gjithashtu, trupi diplomatik i akredituar në Shkup, e ka

vlerësuar lart si njeri me të gjitha atributet e një prijësi fetar, posaçërisht rolin i tij paqësor në “Harabati Baba”, teqe në Tetovë dhe mënyrën e tij, në përballje me diskriminimin ligjor ndaj Komunitetit Bektashian, duke përdorur urtësinë, zgjuarsinë, duke mbetur njeriu me fjalët e urta dhe të ëmbla.

Që nga viti 1992 e në vazhdim, Haxhi Baba Edmond Brahimaj, ka marrë pjesë në trajnime të organizatave prestigjioze ndërkombëtare, kurse doktrimore, simpoziume dhe veprimtari të ndryshme me karakter fetar, human dhe social, ku ka referuar, duke çuar aty zërin dhe eksperiencat e komuniteteve bektashiane të kudondodhura në botë. Kështu, më 1996, referoi në Teheran lidhur me tolerancën bektashiane në trevat e Ballkanit. Më 14 qershor të vitit 2003, në Konferencën Ndërkombëtare, “Fetë dhe Civilizimet në mijëvjeçarin e ri”, referon rreth sfidave të bektashizmit në të ardhmen. Në qershor të vitit 2004, në kuadër të trajnimeve të Organizatës të Komuniteteve fetare tradicionale shqiptare, viziton shtëpinë e Bardhë në SHBA. Nga bordi i kësaj organizate ka merituar titullin “Ambasadori i Paqes”. Ka shkuar në SHBA, ftuar nga Departamenti i Shtetit dhe nga ambasada amerikane në Shqipëri, për një periudhë 21 ditore për diversitetin e fesë në SHBA. Ka marrë pjesë disa herë në festimet e 16 gushtit në Haxhi Bektash të Turqisë, ku është pritur nga drejtues të lartë të shtetit turk si edhe ata të Institutit “Haxhi Bektash Veliut” pranë Universitetit të Gazit në Turqi. Gjithashtu ka qenë i pranishëm dhe ka kontribuar me ligjëratat e tij, në veprimtari analoge në Tiranë, Shkup, Prishtinë, Ohër, Stamboll, Ankara, Afijon, Shtutgart, Keln dhe në Detroit të SHBA-s. Është pjesëmarrës në pelegrinazhin Botërore për Haxhillëk në Mekë, në vitin 2004. Në vitin 2007, merr pjesë në vizitat në vendet e shenjta në Jeruzalem në Izrael. Ka qenë i ftuar në Kongresin e 33-të Botëror për “Liritë Fetare” në Indi dhe ka ndezur pishtarin e këtij aktiviteti, së bashku me udhëheqësin e shquar fetar, Dalai Lama. Ka marrë pjesë në tri konferenca Botërore mbi fenë në Maqedonin e Veriut, në periudhën 2006-2011.

Pas kalimit nga jeta të ish Kryegjyshit Botëror të Bektashinjve, Haxhi Dede Reshat Bardhi, baba Mondit më 11. 06. 2011, zgjidhet në postin e lartë të Kryegjyshit Botëror të Bektashinjve. Këto vite, në vazhdim, si Kryegjysh Botëror i Bektashinjve, Shenjtëria e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, ka punuar me përkushtim, duke vazhduar rrugën e Dede Reshatit Bardhit, traditën bektashiane në marrëdhënie institucionale, brenda dhe jashtë vendit. Ka pasur gjatë kësaj periudhe drejtimi një axhendë të ngjeshur në veprimtari të ndryshme ndërkombëtare nëpër botë. Në vendet e Ballkanit ka pasur mjaftë takime me presidentët e Kryeministrat në Turqi, Bullgari, Rumani, Hungari, Greqi, Maqedonin e Veriut, Kroaci, Slloveni, Bosnjë-Hercogovinë, Kosovë etj.

**Por takimet nga më kryesoret janë:** Takimi me përfaqësuesit e Këshillit të Evropës për çështjet fetare në vitin 2012. Takimi me personalitete të lartë të Turqisë, Kryeministrin Erdogan, Presidentin turk dhe përfaqësuesit e lartë të Komunitetit Mysliman të Turqisë në vitin 2013. Pjesëmarrës në Konferencën për 100 vjetorin e Shoqërisë “Vatra” në vitin 2013, takim me personalitete të Shtëpisë së Bardhë në SHBA me sekretarin e Shtetit Xhon Kerri më 2013, Konferenca Botërore për paqe në Pejë të Kosovës, viti 2013. Vizitë në vendet e shenjta të Irakut, në qytetin Nexhef, Qerbela, Kufe, Bagdat, në prill të vitit 2014. Merr pjesë në Samitin për paqen në Seul, në shtator 2014. Takimi me Papa Françesku në Tiranë, më 21 shtator 2014. Në veprimtarin ndërkombëtare për një paqe mes popujve 9-12 tetor 2014, në Palermo-Itali. Mori pjesë në Marshimin e Bardhë me përfaqësues të katër komuniteteve fetare të Shqipërisë në Parisë të Francës, në janar të vitit 2015. Bëri të mundur realizimin e amanetit të Dede Reshat Bardhit, në përrurimin madhështor të Kryefaltores Bektashiane në Tiranë me pjesëmarrje të personaliteteve nga shumë vende të botës, më 7 shtator të vitit 2015.

Takimi me Papa Françeskun, më 10 maj 2016, në Vatikan. Më 17 qershor të vitit 2016, merr pjesë në inaugurimin e bustit të "Nënë Terezës, në një provincë të Mynihut, organizuar nga Shoqatës Kulturore "Sali Çekaj". Më 4 shtator të vitit 2016, në Romë-Itali, merr pjesë në Shenjtërimin e Nënë Terezës. Takimi me Patriakun Ekumenik i Stambollit, Bartolomeu i Parë, në Stamboll të Turqisë, në shtator të vitit 2016 dhe po në këtë muaj, Akademia Botërore e Paqes, e OKB-s, i jep titullin "Doctor Honoris Causa". Më 9 tetor të vitit 2016, merr pjesë në ceremoninë e shpalljes "Kardinal", të shqiptarit të përvuajtur, Dom Ernest Troshanit. Më 22 mars të vitit 2017, në "Dita e Sulltan Nevruzit", drejton manifestimin madhështor ndërkombëtar, sipas ritualeve bektashiane, aktivitetet i ndjekur nga 27 televizione nga vende të ndryshme të botës. Më 25 maj 2017, është organizator i vitit të dytë "Ditën e Kulturës Bektashiane" në Paris të Francës. Në Qershor të vitit 2017, merr pjesë në "Mëngjesi i Lutjeve", në Berlin të Gjermanisë. Po këtë muaj, organizon veprimtarinë madhështore të 500-vjetorit të veprës, Ballëm Sulltanit Pirit të Dytë të bektashizmit, Tiranë-Martanesh. Në shtator të vitit 2017, merr pjesë në Konferencën e tretë të liderëve fetarë për paqen botërore, në Seul të Koresë së Jugut. Më 11 tetor të vitit 2017, merr pjesë në seminar ndërkombëtar në Shkup, me temë, "Bektashizmi si pasuri". Më 14 tetor 2017, në Shkup të Maqedonisë së Veriut, organizon Konferencës Ndërkombëtare me temë: "The Bektashi religious community under premime", ku relator dhe i ftuar nderi, ka marrë pjesë Josef Eëinerholster, Nënkryetar i Parlamentit Europian. Në tetor 2017, është në takim në Bruksel me anëtarë e PE dhe Reporterin e BE-s për Shqipërinë, Knut Fleckentein, për problemin e teqesë Harabati Baba të Tetovës. Më 29-30 tetor 2017, merr pjesë në Athinë-Greqi, në aktivitetin për paqen e qëndrueshme në Lindjen e Mesme. Në nëntor të vitit 2017, merr pjesë në ceremoninë e ngritjes së bustit të "Nënë Terezës" në Kroaci, së bashku me Presidentin e Republikës së Shqipërisë, z. Ilir Meta, ku edhe takon z. Stipe Mesiç.

Në janar 2018, merr pjesë në Berlin, në Konferencën Ndërkombëtare, "Iraku pas fitores mbi shtetin islamik", organizuar në bashkëpunim me zyrën e Evropës, të dialogut midis feve. Më 7 shkurt 2018, është organizator i jubileut të 480-vjetorit të themelimit të teqesë "Harabati Baba", Tetovë, në Maqedonin e Veriut, me pjesëmarrje nga ambasadat e akredituara në Maqedoni, përfaqësues të OSBE-s, intelektual, profesorë nga vende të Ballkanit dhe Shqipëria. Me këtë rast u bë prezantimi i ekspozitës fotografike në këtë event të rrallë. Nga 18-20 korrik 2018, merr pjesë në Kongresin e Pestë Botëror të Studimeve mbi lindjen e mesme dhe Afrikën Veriore-Spanjë. Nga 29-31 korrik 2018, merr pjesë në takimin e radhës në Kalkutë-Indi. Në gusht 2018, merr pjesë në Eashington D.C, në Ministerialin e Lirive Fetare të organizuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit. Në dhjetor 2018, merr pjesë në Departamentin Amerikan të Shtetit, në takimin për çështjet e Demokracisë dhe të të Drejtave të Njeriut. Më 5 dhjetor 2018, merr pjesë në mëngjesin e 21-të, të lutjes në Europë, i mbajtur në Bruksel në Parlamentin Evropian. Më 1-2 prill 2019, merr pjesë në takimin plotësues të Dimesionit Human, të organizuar nga OSBE në Vjenë. Më 10-12 prill 2019, bën vizitë në vendet e shenjta të Irakut, në qytetet Nexhef, Qerbela, Kufe, Bagdat. Më 14-15 qershor 2019, merr pjesë në Konferencën e Paqes Botërore, në Seul. Më 20 qershor 2019, merr pjesë në Forumin Ndërfetar për Liritë Fetare, në Bruksel. Më 16 korrik 2019, merr pjesë në Ministerialin e Lirive Fetare, të organizuar nga Instituti Amerikan për paqe, në Eashington. Më 13 nëntor 2019, merr pjesë në Samitin e udhëheqësve fetarë në botë, BakuAzerbaijan. Nga 18-20 maj 2022, merr pjesë në aktivitetin mbi tolerancën dhe harmoninë fetare si vlerë e shtuar të popullit shqiptar, në Landin gjerman, të Renanisë Veriore.

Më 30 gusht 2022, Kryegjyshi Botëror Bektashian, Dede Edmond Brahimaj, priti dhe dha një intervistë për gazetarin dhe prezantuesin e njohur të televizionit francez “M6”, Bernard de la Villardiere. Nga 11 deri më 13 maj 2023, zhvilloi një vizitë në Berlin-Gjermani (Mëngjesi i Lutjeve) dhe, në aktivitetin “Mbledhja e 27-të Ndërkombëtare e Berlinit”

**Ka marrë këta tituj nderi:**

- “Ambasador i Paqes”, 2004.
- “Nderi i Qarkut të Korçës”, 2004.
- “Qytetar Nderi” i Komunës Zerqan-Bulqizë., 10 qershor 2014.
- “Qytetar Nderi” i Komunës Martanesh-Bulqizë., 29qershor 2014.
- “Qytetar Nderi” i Komunës Bogovë-Skrapar, 22 gusht 201.
- “Qytetar Nderi” i Komunës Frashër-Përmet, 25 maj 2014.
- “Personalitet i shquar i Labërisë, Shoqata “Labëria”, shkurt 2015.
- “Nderi” i Qarkut të Fierit”, mars 2015.
- “Nderi i Qarkut të Beratit”, maj 2015.
- Urdheri “ Kalorsi i Skenderbeut” 7 shtator 2015 nga Presidenti i Republikës.
- “Dr. Honorus Causa”, Misioni OKB, shator 2016.
- “Nderi i Bashkisë Bulqizë”, tetor 2016.
- Mirënjohje nga Presidentin Obama SHBA, janar 2017.
- Çmimin e Arit” Ikona e Paqes” Shoqata e Kombeve të Bashkuara, “G.O.D Aëards” tetor 2017.
- “Qytetar Nderi” i Skraparit, Bashkia Skrapar, janar 2018.
- “Qytetar Nderi” i Shoqatës Atdhetare Kulturore Mbarëkombëtare”Vëllezërit Frashëri”-Përmet, maj 2018.
- Flamuri Amerikan për “Për kontributin e shquar në përhapjen e fjalës së Zotit dhe vlerave më të larta mes njerëzve” nga Kongresi Amerikan, qershor 2018.
- Çmimi “Profili i Kurajos” qershor 2018 nga Kongresi Hebraik Amerikan.
- “Qytetar Nderi i Memaliajt”. Këshilli Bashkiak i Memaliajt, në vitin 2019.
- Medalje “Gjergj Kastriot Skënderbeu” nga Qeveria e Kosovës 17 korrik 1919.
- Në janar 2021, Shenjtëria e Tij drejtoi Kryesinë e Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë dhe më dt.22 mars 2021, Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë iu dha medalja e lartë “Nderi i Kombit” nga Presidenti i Republikës.
- Nëntor 2021, Akademia e Shkencës dhe e Artit të Europës, në Universiteti Teknik i Këlnit, Gjermani iu dha çmimi “Unaza e Tolerancës”, me motivacionin “për përpjekjet dhe mundimet e vlefshme në angazhimet për paqen dhe nxitjen e dialogut ndërfetar, si shembull i veçantë dhe i denjë për tu ndjekur në ndërtimin, promovimin dhe mbrojtjen e tolerancës”.
- 17 dhjetor 2022, Këshilli Universal i Paqes dhe Misioni Diplomatik për Paqe dhe Prosperitet-Tiranë vlerësuan me çmime mirënjohjeje Kryegjyshin Botëror Bektashian, Shenjtëria e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, për kontributin e dhënë në shërbim të paqes dhe të prosperitetit disa tituj: “Çmimi i Artë i Ekselencës Njerëzore”, shoqëruar me medaljen: “Njeriu i Artë”, si dhe me titullin: “Ambasador i Paqes Universale”.
- “ Nderi i Qarkut të Vlorës”, janar 2023.
- “Nderi i Qarkut të Gjirokastrës”, u dha në Tepelenë , 14 prill 2023.
- “Qytetar Nderi i Bashkisë Tepelenë”, u dha në Tepelenë, 14 prill 2023